



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:198057

Datë: 26.10.2021

Numri i dokumentit: 02321388

P.nr.1007/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Fidan Hoxha, me sekretaren juridike Ardijana Reshtani, në lëndën penale ndaj të akuzuarit H.Sh., nga Prizreni, për shkak të veprës penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, nën numrin PP/II.nr.1736-8/21 të datës 16.09.2021, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe publik, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Labinot Jetishi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. S.M., , më 30.09.2021 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.10.2021, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

H.Sh., nga i ati, dhe e ëma, të vajzërisë, i lindur me datënë Prizren, me vendbanim në rrugën “.....” nr....., ka të kryer shkollën e mesme, punëtor fizik, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 05.09.2021, rreth orës 18:35 minuta, në Prizren, në rrugën “.....”, i akuzuari me forcë ka tentuar t’i pengoj personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, zyrtarin policor – të dëmtuarin L.Th., ashtu që gjatë realizimit të një intervenimi për ta kapur dhe arrestuar vëllain e të akuzuarit, në lidhje me lëndët narkotike, derisa zyrtari policor – këtu i dëmtuari L.Th., i është vënë nga pas të vëllait të akuzuarit, që ta kap atë, i akuzuari fillimisht i del atij përpara që ta ndal zyrtarin policor duke dashur ta kap për trupi, mirëpo zyrtari policor arrin t’i shmanget të akuzuarit H.Sh., dhe ta vë nën kontroll të dyshuarin për narkotik – këtu të vëllain e të akuzuarit. Në atë moment i akuzuari fillon me fjalët: “s’mundeni me arrestu, kush jeni ju, kush k... jeni ju me hi këtu e me arrestu vëllain tim, banu prej këtuhi, lirone vëllain”, me të cilat veprime ka tentuar t’i pengojë zyrtarët policor t’i kryejnë detyrat e tyre zyrtare.

Me këto veprime kryen veprën penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 7, 8, 9, 10, 17, 47, 48, 49, 69, 79 dhe nenit 401 par.5 lidhur me par.1 dhe 4 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton dënimin me burgim me kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej një (1) viti pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nëse i akuzuari nuk kryen veprë tjetër penale, ndërsa në rast të revokimit të këtij dënimi do ti llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit prej datës 05.09.2021 deri më datë 30.09.2019.

I dëmtuari L.Th., nga fshati, Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzetë (20) Euro, si dhe shumë prej tridhjetë (30) Euro në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit, në afatin ligjor prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti Përgjithshëm, kësaj gjykate ia ka parashtruar aktakuzën nën numrin PP/II.nr.1736-8/21 të datës 16.09.2021, ndaj të akuzuarit H.Sh., nga Prizreni, për shkak të veprës penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar i akuzuari H.Sh., e ka pranuar fajësinë për veprën penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së, gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë, i cili pranim është bërë konform nenit 248 të KPP-së, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të cilin pranim e ka bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve edhe me mbrojtësin e tij. Pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 par.2. të KPP-së dhe se gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së, pasi që me datë 05.09.2021, rreth orës 18:35 minuta, në rrugën “.....” në Prizren, i akuzuari H.Sh., me dashje, me anë të forcës fizike ka tentuar t’i pengoj personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare. Zyrtari policor – këtu i dëmtuari L.Th., teksa i ishte vënë pas të vëllait të akuzuarit që ta arrestonte në lidhje me lëndët narkotike, këtu i akuzuari H.Sh., ndërhyrë që ta pengoj zyrtarin policor në kryerjen e detyrës së tij, duke i dal përpara dhe pastaj duke dashur ta kap për trupi. Mirëpo zyrtari policor – këtu i dëmtuari L.Th., i shmanget të akuzuarit dhe e vë nën kontroll të dyshuarin për narkotik – vëllain e të akuzuarit. Në atë moment i akuzuari fillon me fjalët: “s’mundeni me arrestu, kush jeni ju, kush k... jeni ju me hi këtu e me arrestu vëllain tim, banu prej këtuhi, lirone vëllain”, me të cilat veprime ka tentuar t’i pengojë zyrtarët policor që të kryejnë detyrat e tyre zyrtare, për çka gjykata e shpalli fajtor dhe i’a shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtin duke marrë parasysh qëllimin e dënimit e me kusht, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë, motivet nga të cilat është kryer vepra penale, prej rrethanave lehtësuese mori parasysh faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar dhe gjendjen ekonomike. Pasi që rrethana rënduese nuk gjeti gjykata është e mendimit se dënimi i këtillë i shqiptuar si në dispozitiv është në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe se me këtë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 47 të KPRK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike u mor në kuptim të nenit 463 par.2 të KPK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së. Ndërsa vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë në pajtim me nenin 39 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
2021:198057, 26.10.2021**

G j y q t a r i

Fidan Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.